



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr.352, datë 06.07.2023**

**PËR  
KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT {...}  
DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË  
GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
DURRËS, PËR POZICIONIN  
E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME  
VENDIMIN NR. 22, DATË 18.01.2023, DHE PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS PËR  
POZICIONIN E SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 23, DATË 18.01.2023  
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 06.07.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Dritan Hallunaj, pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 22, datë 18.01.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 23, datë 18.01.2023,

**V Ë R E N**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Me Vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr.20, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe me vendimet nr. 21 deri nr.24, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 18.01.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 01.02.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr.22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 kandidoi edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati) gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit 22/2023 dhe 23/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

5. Me Vendimin nr.295, datë 30.05.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim”, Këshilli ka vendosur:

*“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim.*

*II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...Për kandidatin z. {...}- relator z. Dritan Hallunaj;...”*

6. Më datë 30.05.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes komunikimit elektronik<sup>1</sup>, për kandidatin z. {...} u kërkuar dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve

<sup>1</sup> Përmes komunikimit elektronik të datës 31.05.2023

personale dhe regjistrit të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

9. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me komunikimin elektronik datë 31.05.2023, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

10. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, me anë të shkresës nr. 3167 prot., datë 01.06.2023, informacioni u kërkua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë. Kjo e fundit ktheu përgjigje me shkresën nr.416/1 prot., datë 05.06.2023, protokolluar më datë 3167/1 prot., datë 12.06.2023, siç do të përshkruhet më poshtë.

11. Më datë 09.06.2023 kandidati z. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 23, datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3318 prot., datë 09.06.2023, duke parashtruar se:... *“Deklaroj se heq dorë nga aplikimi për lëvizjen paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”*. Sa më sipër referuar, verifikimi lidhur me kriteret ligjore u zhvillua vetëm për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023 të Këshillit.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT**

### **12. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale specifike minimale”**

13. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit nr. 22, datë 18.01.2023, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se **gjatë pesë viteve të fundit** nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.

14. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr.22, datë 18.01.2023, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

15. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai është emëruar në muajin korrik 2019 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibrë, ku ka ushtruar funksionin që nga ajo kohë dhe në vijim.

16. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 20.07.2011, dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë civile” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2013. Në vijim ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendim nr. 130, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 153, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

17. Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, rezulton se për periudhën nga 31 korrik 2019 deri më datë 30.04.2023 (kur ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër) dhe nga data 01.05.2023 e në vijim, që ushtron detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ai ka gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve, penale, civile, familjare dhe tregtare, në kushtet kur gjykata, për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, nuk ka qenë e ndarë në seksione apo dhoma të veçanta, penale dhe civile.

**18. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 22, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.**

**19. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.**

20. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimit nr. 22, datë 18.01.2023, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë .... nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”*

21. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” që është pa datë të caktuar në të, por duke patur parasysh paraqitjen e tij bashkëlidhur kërkesës për aplikim, dhe që kjo e fundit ka datë 30.01.2023, si datë të vetëdeklarimit përcaktohet kjo e fundit. Nëpërmjet vetëdeklarimit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

22. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

**23. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.**

**24. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.**

25. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit nr. 22, datë 18.01.2023, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efienca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

26. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” që është pa datë të caktuar në të, por duke patur parasysh paraqitjen e tij bashkëlidhur kërkesës për aplikim, dhe që kjo e fundit ka datë 30.01.2023, si datë të vetëdeklarimit përcaktohet kjo e fundit. Nëpërmjet vetëdeklarimit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

27. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

**28. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.**

### III. KONKLUZIONE

29. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit të Këshillit nr.22, datë 18.01.2023, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit të z. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin në fushën e të drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin. Gjithashtu, ndërsa rezulton që kandidati z. {...}, të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e tij për t’u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 23, datë 18.01.2023, Këshilli i Lartë

Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për këtë kandidat, lidhur me pozicionin e mësipërm.

30. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të tre kritereve të sipërpërmendura të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, dhe përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 22, datë 18.01.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”; si dhe të vendimit nr.23, datë 18.01.2023, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”,

### **VENDOSI:**

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**